

VENDIM
Nr.151,datë 29.12.2014

PËRFILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “ALBANIAN ENERGY SUPPLIER” SHPK NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 3, pika 31; 8 pika 2,germa “a”; 9; 45 pikat 3 dhe 4 dhe 48, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “P”; 5 pika 1 germa “P”8; 10, pika 1 dhe 3, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa “a”, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve, nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë(ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.12.2014, pasishqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Albanian Energy Supplier” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Albanian Energy Supplier” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

Për dokumentacionin e përgjithshëm

- Neni 9, pika 1.Formati i aplikimit ështëplotësuar nëmënyrë korrekte.
- Neni 9, pika 2. Dokumentacioni juridik, administrator dhe pronësorështë i plotësuar tërësisht.
- Neni 9, pika 3. Dokumentacioni financiar dhe fiskalështë i plotësuar tërësisht.
- Neni 9, pika 4/9.Germa “a”, “b” dhe “c” janë paraqitur dhe plotësuar korrekt.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Albanian Energy Supplier” sh.p.k., për licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti